

UNMIK/REG/2006/26
27 prill 2006

RREGULLORE NR. 2006/26

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2001/19
MBI DEGËN E EKZEKUTIVIT TË INSTITUCIONEVE TË
PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 më 13 shtator 2001 mbi themelimin e Degës së Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, që më vonë është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/5 të datës 4 mars 2002, me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/15 të datës 16 mars 2005 dhe me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/53 të datës 20 dhjetor 2005,

Pas konsultimit të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës,

Pas vlerësimit pozitiv të rezultatit të shqyrtimit të periudhës së përkohshme në pajtim me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/53,

Me qëllim të ndryshimit të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 për caktimin e kompetencave shtesë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme,

Duke ripohuar pushtetin suprem të PSSP-së dhe kompetencat e përgjegjësitë e rezervuara të tij sipas kapitullit 8 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë që janë të lidhura me këtë fushë,

Pa cenuar përgjegjësinë e UNMIK-ut për të monitoruar përmes personelit ndërkombëtarë dhe policëve ushtrimin e të gjitha kompetencave të transferuara në Ministrinë e Drejtësisë dhe asaj të Punëve të Brendshme dhe për të intervenuar, kur janë të autorizuar dhe kur është e nevojshme në emër të PSSP-së, si dhe pa cenuar obligimin e ministrit të Drejtësisë dhe atij të Punëve të Brendshme dhe stafit të tyre që të bashkëpunojnë plotësisht me UNMIK-un në këtë aspekt;

Duke ripohuar dispozitat përmes të cilave udhëhiqen gjyqtarët dhe prokurorët ndërkombëtarë, në Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/6 të datës 15 shkurt 2000 mbi emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë dhe Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/64 të datës 15 dhjetor 2000 mbi caktimin e gjyqtarëve/prokurorëve ndërkombëtarë dhe/ose ndryshimin e vendit të gjyqit,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1 Ndryshimi

Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shtojca XV dhe shtojca XVI, që i bashkëngjitet Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 që kanë të bëjnë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme do të zëvendësohen me shtojcën XV dhe shtojcën XVI që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje.

Neni 2 Transferimi i stafit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës

2.1 Ministria e Drejtësisë do të merr përsipër dhe do të jetë kompetente për punësimin e stafit, pagat e të cilëve paguhën nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe përgjegjësitë e të cilëve bien në kompetencat e transferuara Ministrisë, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/53 apo me këtë Rregullore. Punonjësit e tillë vazhdojnë punën si shërbyes civil në Ministrinë e Drejtësisë. Përfshirja bëjnë ndërkombëtarët e angazhuar nga Departamenti i Drejtësisë.

2.2 Pavarësisht nga ndryshimi i autoritetit punëdhënës, kontratat e punës së stafit nga neni 2.1 mbesin të pandryshuara në të gjitha aspektet tjera, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen.

Neni 3 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 27 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Shtojca XV
Ministria e Drejtësisë

Ministria:

- (i) Zhvillon politikën brenda fushës së saj të përgjegjësisë, mundëson përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë, përfshirë edhe prokurorinë publike. Kjo nuk përfshin çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e gjyqësisë dhe gjykatave;
- (ii) Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë menaxhon çështjet administrative, financiare dhe buxhetore të Ministrisë dhe zhvillimin e rregullave administrative, teknike e financiare dhe rregullave me të cilat përcaktohet puna e personelit ndihmës dhe burimet materiale për të siguruar funksionim efikas të sistemit të prokurorisë pa kufizuar, penguar ose ndërhyrë në asnjë mënyrë në veprimet e Prokurorisë Publike dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- (iii) Siguron udhëzime për zhvillimin dhe zbatimin e politikave prokuroriale në Prokurorinë Publike të Kosovës, që nuk kufizojnë, pengojnë ose ndërhyjnë në asnjë mënyrë në veprimet e Prokurorisë Publike dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- (iv) Ofron aftësimin, përfshirë aftësimin profesional dhe të prokurorëve në bashkëpunim me Institutin Gjyqësor të Kosovës;
- (v) Organizon provime për kualifikimin e prokurorëve, të avokatëve (përfshirë përfaqësuesit ligjorë) dhe për profesionistët tjerë ligjorë përmes Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe organeve të tjera profesionale të pavarura;
- (vi) Siguron informacione dhe të dhëna statistikore mbi të gjitha aktivitetet e drejtuara nën autorizimin e Ministrisë, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me ligjin në fuqi;
- (vii) Ushtron mbikëqyrje ekzekutive mbi tërë shërbimin korrektues dhe shërbimin sprovues në burgun e Dubravës, përveç rasteve emergjente, ku UNMIK-u ruan dhe ushtron kompetencat për të komanduar dhe ushtruar të gjitha operacionet. UNMIK-u përcakton kur paraqitet gjendje emergjente dhe kohëzgjatjen e saj;
- (viii) Zhvillon dhe zbaton politika për të siguruar qasje të drejtë dhe efektive në sistemin e drejtësisë për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve në pajtim

me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/25 mbi Kornizën rregullative të sistemit të drejtësisë në Kosovë;

- (ix) Ushtron përgjegjësitë në kërkimin, marrjen, sigurimin dhe verifikimin e informacioneve lidhur me vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur dhe kthimin e eshtrave të personave të zhdukur, shfrytëzimin e ndihmës dhe ekspertizës së personelit të Zyrës për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore si dhe të specialistëve të tjerë, me autorizimin e UNMIK-ut për të gjitha hetimet e rasteve individuale të zhdukjes;
- (x) Ushtron përgjegjësitë për çështjet që kanë të bëjnë me mjekësinë ligjore, duke përfshirë edhe administrimin e Zyrës së mjekut kontrollues që i nënshtrohet mbikëqyrjes së UNMIK-ut për certifikimin dhe trajnimin e kërkuar të personelit që punon në Zyrën e kontrolluesit mjekësor dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare nga ana e këtij personeli. Mirëpo UNMIK-u do të ruajë kontrollin direkt mbi të gjitha kontrollimet e mjekësisë ligjore dhe raportet e ekspertëve lidhur me rastet penale, të cilat janë nën përgjegjësinë e prokurorëve ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe rastet e krimit të organizuar, krimet ndaj pakicave etnike, terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore;
- (xi) Ofron ndihmë për viktimat e krimit, veçanërisht për viktimat e dhunës familjare dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbikëqyrë Zyrën e koordinatorit për ndihmë viktimave të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/4;
- (xii) Sipas nevojës ndihmon UNMIK-un në ushtrimin e përgjegjësiave për ndihmë juridike ndërkombëtare dhe bashkëpunim, duke përfshirë edhe bashkëpunimin me Gjykatën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, me Gjykatën Ndërkombëtare Penale dhe me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë;
- (xiii) Përfaqëson Qeverinë në konteste dhe procedura pranë gjykatave dhe tribunaleve të arbitrazhit;
- (xiv) Ofron mbështetje me ekspertë në përgatitjen e marrëveshjeve të Qeverisë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, në mënyrë që ato të jenë në përputhshje me Kornizën Kushtetuese dhe
- (xv) Kryen çdo detyrë tjetër që i caktohet Ministrisë me ligj.

Shtojca XVI

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria:

- (i) Administron çështjet financiare dhe buxhetore në Ministrinë e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë;
- (ii) Harton politikën brenda fushës së përgjegjësive të saj, ndihmon përgatitjen e legjislacionit dhe zbatimin e tij në fushën e rendit dhe sigurisë publike;
- (iii) Mbikëqyrë Shërbimin Policor të Kosovës, me autorizimin e PSSP-së, duke vepruar përmes komisionerit të policisë dhe pa ndërhyrë në veprimet e Shërbimit Policor të Kosovës dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- (iv) Mbikëqyrë administrimin buxhetor dhe financiar të Shërbimit Policor të Kosovës në konsultim me komisionerin e policisë, i cili është përgjegjës për menaxhimin e buxhetit;
- (v) Udhëzon zëvendëskomisionerin e policisë të Shërbimit Policor të Kosovës mbi trajnimin e policëve, në bashkërendim me komisionerin e policisë dhe në pajtim me standardet e Bordit të Kosovës mbi standardet e sigurisë publike dhe arsimit;
- (vi) Duke vepruar përmes Inspektoratit të Policisë, mbikëqyrë menaxhimin dhe punën e Shërbimit Policor të Kosovës, duke përfshirë edhe procedurat disiplinore ndaj policëve, në pajtim me ligjin në fuqi dhe me Komisionin për Emërime të Larta dhe Disiplinë (KELD);
- (vii) Dorëzon propozimet buxhetore për Inspektoratin e Policisë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave në emër të Inspektoratit të Policisë;
- (viii) Në konsultim me Shërbimin Policor të Kosovës dhe me UNMIK-un ushtron përgjegjësitë për zbatimin e menaxhimit të integruar kufitar lidhur me vendosjen e pikave kufitare/të kufijve administrativ, në pajtim me standardet e caktuara nga Bashkimi Evropian, për bashkërendimin efektiv ndërmjet policisë dhe autoriteteve të tjera publike të përfshirë në kontrollimin e kalimit të kufirit, pa ndërhyrë në veprimet e Shërbimit Policor të Kosovës dhe në zbatimin e hetimeve penale;
- (ix) Në bashkërendim me UNMIK-un zbaton, ligjin në fuqi lidhur me lëvizjen e personave brenda dhe jashtë Kosovës dhe ndihmon në shqyrtimin e kërkesave për statusin e refugjatit, në pajtim me ligjin në fuqi, në bashkëpunim me UNHCR-në;

- (x) Duke vepruar përmes UNMIK-ut, bashkëpunon me shërbimet, me agjencitë dhe me organizatat ndërkombëtare të cilat janë përgjegjëse në fushën e sigurisë dhe rendit publik;
- (xi) Zhvillon dhe zbaton strategjinë mbi marrëdhëniet publike të Ministrisë;
- (xii) Së bashku me Shërbimin Policor të Kosovës zhvillon dhe zbaton strategjinë për bashkëpunim me organet tjera publike, të cilat janë përgjegjëse në fushën e sigurisë dhe rendit publik, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në këshill(at)in komunal për sigurinë e komunitetit (KKSK) dhe në komite(et)in lokal për siguri publike (KLSP);
- (xiii) Ndhmon UNMIK-un në administrimin dhe mirëmbajtjen e regjistrimit qendror civil dhe bazën e të dhënave, që është nën autoritetin dhe kontrollin e PSSP-së;
- (xiv) Ndhmon UNMIK-un në administrimin e letërnjoftimeve dhe dokumenteve të udhëtimit, të cilat lëshohen nën autoritetin dhe kontrollin e PSSP-së dhe ushtron përgjegjësinë për lëshimin e të gjitha dokumenteve të tjera civile dhe regjistrimin e automjeteve;
- (xv) Mbledh, mirëmban dhe analizon të dhënat statistikore dhe informacionet në fushën e sigurisë e të rendit publik në pajtim me ligjin në fuqi;
- (xvi) Kryen funksione lidhur me përgatitjet për emergjenca civile në pajtim me paragrafin 5.5 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe
- (xvii) Kryen detyra të tjera që i caktohen Ministrisë me ligj.